

RAPORT INDIVIDUAL I KONSULTIMIT PUBLIK

për projektvendimin:

“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2026–2030”.

1. Titulli i projektaktit:

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2026–2030”

Përmes një qasjeje të integruar të politikave publike, strategjia synon të forcojë rolin e sektorit kulturor si një faktor ndërsektorial që kontribuon në mirëqenien e qytetarëve, në zhvillimin territorial të balancuar dhe në konsolidimin e qeverisjes demokratike. Deri në vitin 2030, Shqipëria synon të konsolidojë pozicionin e saj si një qendër kulturore me rëndësi në Ballkanin Perëndimor dhe si një aktore aktive në hapësirën kulturore evropiane. Ky objektiv do të mbështetet në valorizimin e trashëgimisë së pasur kulturore dhe në zhvillimin e një ekosistemi të qëndrueshëm dhe dinamik krijues, i cili promovon pjesëmarrjen kulturore, nxit dialogun ndërkulturor dhe kontribuon në rritjen ekonomike të udhëhequr nga inovacioni dhe industritë kulturore dhe krijuese.

Ky projektvendim ka si objektiv që deri në vitin 2030, Shqipëria të pozicionohet si një vend me kulturë bashkëkohore mesdhetare: një shtet që vlerëson diversitetin e tij historik dhe territorial si një burim inovacioni dhe dialogu. Vizioni i strategjisë duhet të mbështetet në idenë e një ekosistemi kulturor, në të cilin mbrojtja e trashëgimisë, prodhimi krijues, arsimi dhe kërkimi janë të ndërlidhura brenda një sistemi koherent të nxitur nga cilësia, bashkëpunimi dhe përfshirja.

Në kontekstin shqiptar, kultura duhet t'i përgjigjet tre sfidave kryesore:

1. Forcimit të kohezionit social dhe territorial
2. Ndërlidhjes me ekonominë dhe zhvillimin e qëndrueshëm
3. Zhvillimi i diplomacisë kulturore në nivel ndërkombëtar

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse

kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtime e kohëzgjatjes.

Konsultimi publik për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2026–2030 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj” u zhvillua nëpërmjet Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) për një periudhë prej 20 ditësh pune, duke filluar nga data 25.5.2026 deri në datën 22.6.2026, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Gjatë kësaj periudhe, grupet e interesit patën mundësinë të paraqisnin komente, sugjerime dhe rekomandime nëpërmjet platformës elektronike të konsultimit publik, adresës zyrtare të emailit, si dhe gjatë takimeve konsultative dhe aktiviteteve prezantuese të organizuara nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Në kuadër të këtij procesi, u organizuan takime konsultative dhe prezantuese më datë 20.2.2026 në Hangart (godine pranë ministrisë) dhe në 3.6.2026 në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP), me qëllim prezantimin e projektaktit dhe mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve nga grupet e interesit.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare Për Kulturën 2026–2030”, ishin:

- Konsultimi elektronik përmes Regjistrisë Elektronike, RENJK (25.5.2026 - 22.6.2026).
- Konsultimi nëpërmjet email-it zyrtar.
- Takime konsultative dhe prezantuese në datë 20.2.2026 në Hangart (godine pranë ministrisë) dhe në 3.6.2026 në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP).

Në RENJKP janë regjistruar 736 shikime.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit. Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Ky projektvendim është hartuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit me mbështetjen teknike të Agjencise Italiane të Zhvillimit nëpërmjet Fondacionit Santagata.

Në procesin e konsultimit publik kanë kontribuar institucione shtetërore, organizata ndërkombëtare (UN Women, CULTUR-AL), organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të diasporës (përfshirë AKD), si dhe artistë, ekspertë dhe individë të interesuar.

5. Pasqyra e komenteve me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nga procesi i konsultimit të projektvendimit ka patur 9 (nëntë) komente të cilat paraqiten më poshtë:

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Diplomacia kulturore dhe diaspora	Kërkohej forcimi i rolit të diasporës në promovimin e kulturës shqiptare, përfshirja e AKD-	AKD	Pranohet pjesërisht	Roli i diasporës dhe bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse janë reflektuar në objektivat

	së në mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit, si dhe zhvillimi i instrumenteve dhe programeve për bashkëpunimin kulturor me diasporën.			e strategjisë. Disa prej propozimeve specifike do të trajtohen në planin e veprimit dhe gjatë zbatimit të dokumentit.
Përfshirja e diasporës në ruajtjen e trashëgimisë dhe edukimin kulturor	Sugjerohet përfshirja e komuniteteve shqiptare jashtë vendit në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, edukimin kulturor dhe proceset e digjitalizimit.	AKD	Pranohet	Komentet përputhen me objektivat e strategjisë për promovimin ndërkombëtar të kulturës shqiptare dhe forcimin e lidhjeve kulturore me diasporën.
Integrimi gjinor	Kërkohet përfshirja e analizës gjinore, statistikave të ndara sipas gjinisë, treguesve gjinorë dhe monitorimi i ndikimit të politikave kulturore mbi gratë dhe burrat.	UN Ëomen	Pranohet pjesërisht	Perspektiva gjinore është reflektuar në planin e veprimit dhe kornizën e monitorimit. Treguesit dhe mekanizmat e monitorimit do të mundësojnë mbledhjen progresive të të dhënave sipas gjinisë gjatë zbatimit të strategjisë.
Qasja ndërsektoriale e kulturës	Sugjerohet forcimi i rolit të kulturës si politikë ndërsektoriale dhe rritja e bashkëpunimit me	CULTUR -AL	Pranohet	Komenti mbështet objektivat e strategjisë dhe forcon qasjen e integruar të politikave publike në sektorin kulturor.

	sektorët e arsimit, turizmit, zhvillimit vendor, ekonomisë dhe inovacionit.			
Transparenc a, monitorimi dhe financimi	Kërkohet rritja e transparencës financiare, publikimi i të dhënave për financimin, forcimi i monitorimit dhe raportimit të rezultateve.	CULTUR -AL	Pranohet pjesërisht	Rekomandimet janë reflektuar në planin e veprimit dhe në kornizën e monitorimit. Forma konkrete e instrumenteve të transparencës do të përcaktohet gjatë zbatimit.
Shoqëria civile dhe pjesëmarrja qytetare	Sugjerohet forcimi i rolit të organizatave të shoqërisë civile në zbatimin, monitorimin dhe konsultimin e politikave kulturore.	CULTUR -AL	Pranohet	Përputhet me parimet e qeverisjes së hapur dhe pjesëmarrjes së aktorëve të interesit në sektorin kulturor.
Digjitalizim i dhe trashëgimia kulturore	Sugjerohen masa shtesë për dokumentimin, digjitalizimin, aksesueshmërinë dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale.	CULTUR -AL	Pranohet	Sugjerimet janë në përputhje me objektivat e transformimit digjital dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.
Industritë krijuese, artistët dhe infrastruktur a kulturore	Kërkohet forcimi i mbështetjes për industritë krijuese, Statusin e Artistit, zhvillimin e infrastrukturës kulturore dhe	CULTUR -AL	Pranohet pjesërisht	Objektivat janë reflektuar në strategji, ndërsa masat konkrete dhe instrumentet financiare do të detajohen në fazën e zbatimit dhe në

	përmirësimin e aksesit në kulturë.			dokumentet përkatëse zbatuese.
Qartësia e kuadrit institucional , financiar dhe mekanizma ve të zbatimit të strategjisë	Paqartesi ne lidhje me dokumentacionet e shfaqura: 1-Mungese te qartesisë normative dhe hierarkisë ligjore. Nuk përcaktohet statusi juridik i "prioriteteve te panegociueshme". 2- Pika 1- sjell paqartesi ne detyrimet financiare, te cilat nga ana tjeter jane te paqarta dhe ne vetvete. si harmonizohet kjo strategji si pjese e trupit te sistemit buxhetor ne Shqiperi? 3-Shume paqartesi rreth strukturave te reja apo emertimeve te reja: cfare janë ?, cfare kompetencash ekzekutive kanë ?, a jane vetem struktura kordinuese ?, kush mban pergjegjesi ligjore per vendimmarrje te tyre ?, të gjitha këto "engjej biznesi	Laboreta Skraqi	Pranohet pjesërisht	Komenti paraqet vlerësime dhe kërkesa për sqarime lidhur me elemente të ndryshme të dokumentit strategjik Strategjia Kombëtare e Kulturës 2026–2030 është një dokument politikash publike, i cili përcakton vizionin, objektivat strategjike, prioritetet dhe drejtimet kryesore të zhvillimit të sektorit kulturor dhe nuk ka natyrën e një akti normativ që rregullon në mënyrë të detajuar kompetenca, procedura administrative apo struktura institucionale. Dokumenti është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe metodologjik në fuqi për planifikimin strategjik dhe zbatimin e tij do të realizohet nëpërmjet planit të veprimit, akteve përkatëse zbatuese dhe legjislacionit sektorial në fuqi. Instrumentet financiare, mekanizmat e monitorimit, treguesit e performancës, si dhe rolet dhe përgjegjësitë institucionale janë

	kulturator" etj etj kane nje mungese baze ligjore (te pakten orientuese edhe i lexojme vet ne pastaj), sepse per ndryshet krijohet fragmentarizimi i instrumenteve financiare. 4-Si jane dhe kush jane instrumentat mates te "tregusve te performances"? 5- Nuk shihet askund se si do te funksionojë decentralizimi kulturor. A parashikohet ketu ndryshim ne ligjin e veteqeverisjes vendore? Kjo eshte pjese tmerresisht shume e paqarte. Ju lutem, tregoni gjithashtu edhe emrat e personave qe kane dhene kohe nga jeta e tyre per te formesuar kete strategji sepse nuk eshte e lehte. Ministria e Kultures, Turizmit (dhe Sportit) eshte nje institucion identiteti per cdo vend, duhet te kete			trajtuar në nivel strategjik dhe do të zhvillohen më tej në fazën e zbatimit, në përputhje me kompetencat e institucioneve përgjegjëse dhe kuadrin ekzistues ligjor. Gjithashtu, strategjia nuk parashikon ndryshime të drejtpërdrejta në legjislacionin për vetëqeverisjen vendore dhe as krijimin e strukturave të reja me kompetenca vendimmarrëse jashtë kuadrit ligjor në fuqi. Për rrjedhojë, nuk vlerësohet e nevojshme reflektimi i komenteve në tekstin e strategjisë.
--	---	--	--	--

	vizion shumedimensional per te ruajtur vleren e vendit.			
--	--	--	--	--

Vendimi i marrë dhe arsyetimi

Komentet dhe sugjerimet e paraqitura gjatë procesit të konsultimit u shqyrtuan nga grupi i punës përgjegjës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2026–2030. Një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve u pranua ose u pranua pjesërisht, pasi përputheshin me objektivat strategjike të dokumentit dhe kontribuonin në forcimin e qasjes ndërsektoriale, promovimin e përfshirjes, zhvillimin e diplomacisë kulturore, integrimin e perspektivës gjinore, rritjen e transparencës dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit.

Në rastet kur rekomandimet nuk u reflektuan plotësisht në tekstin e strategjisë, kjo ndodhi për shkak se ato janë adresuar në Planin e Veprimit dhe Kornizën e Monitorimit, ose sepse kërkonin masa të detajuara zbatuese, implikime shtesë financiare apo rregullime që tejkalojnë natyrën dhe fushëveprimin e dokumentit strategjik. Në këto raste, sugjerimet janë marrë në konsideratë për fazën e zbatimit të strategjisë dhe për hartimin e instrumenteve përkatëse zbatuese.

Si rezultat i procesit të konsultimit, dokumenti u përmirësua duke reflektuar rekomandimet që forcojnë rolin e kulturës në zhvillimin social dhe ekonomik, promovimin ndërkombëtar të kulturës shqiptare, pjesëmarrjen e diasporës, përfshirjen e perspektivës gjinore, transparencën e financimit, zhvillimin e industrive krijuese, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe transformimin digjital të sektorit kulturor.